

Driton (Mujë) Zeneli–Faton

(31.05.1972, shqiptar nga Jabllanica/Jablanica, komuna e Gjakovës/Đakovica, punëtor arsimor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Dritoni punonte para lufte si teknik aviacioni në aeroportin e Podgoricës [Mali i Zi]. Më pas, u kthye në Kosovë, ku e mbaroi Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe u punësua si arsimtar i matematikës në fshatrat e Doblilabes/Doblilabe dhe Dolit/Dolj. Në UÇK ka aderuar më 5.04.1998. Në fillim të angazhimit të tij ushtarak, ishte i ngarkuar me trajnimin e ushtarëve të rinj. Pastaj, në gusht të vitit 1998, u emërua komandant i shtabit të UÇK-së në fshatin **Jabllanicë/Jablanica**. Në fillim të shtatorit, ai gjendej i pozicionuar te vendi i quajtur *Pika e Shqiponjës/Orlovo gnezdo*. Ka rënë më **8.09.1998** nga goditja e një predhë tanku, gjatë luftimeve shumëditëshe me forcat serbe. Trupi i tij u transferua nga forcat serbe me helikopter në drejtim të panjohur. Mbetjet e tij mortore janë zbuluar më 20.06.1999 në varrezat e qytetit të Pejës/Peć. Po atë ditë, ai është varrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Jabllanicë/Jablanica.

Burimet: deklarata Z.X, FDH-35409; deklarata A.Z, FDH-6699; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFEDUÇK, *Feniksët...4*, 277-279.

Dinë (Miftar) Çekaj

(13.03.1951, shqiptar nga Irzniqi/Rznić, komuna e Deçanit/Dečani, profesor, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Dinë Çekaj u inkadrua në radhët e UÇK-së më 24.04.1998. Ishte i pozicionuar në fshatin e vet të Irzniqi/Rznić. Në datën 8.09.1998, ka shkuar në **Skivjan/Skivjane** për një vizitë të bashkëshortja Nushe dhe fëmijët, që ishin strehuar atje për shkak të sigurisë. Ditën tjetër, më **9.09.1998**, ai u nis mbrapa për në Irzniqi/Rznić në orët e pasdites. Pas pak, familjarët dëgjuan të shtëna. Nuk shkoi shumë dhe një komshi i Çekajëve erdhi dhe u tha se pjesëtarë të forcave serbe e kishin qëlluar për vdekje Dinin në livadhet e fshatit Skivjan/Skivjane. Për shkak të pranisë së madhe të forcave serbe, askush nga familja apo bashkëfshatarët e tij nuk ka mundur të shkonte në vendin

e vrasjes për ta tërhequr trupin. Ditën e nesërme, vëllai i Nushe e ka marr trupin e viktimës, i cili në ndërkohë ishte bartur në morgun e Gjakovës/Đakovica. Po atë ditë, Dinë Çekaj u varros në varrezat e Skivjanit/Skivjan. Pas përfundimit të luftës, në vitin 2000, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Irzniqi/Rznić.

Burimet: deklarata N.C, FDH-30772; SMIP, *Teroristički...*, III, 140; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCJG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Faze (Ramadan Sadrija) Alija

(1948, shqiptare nga Kralani/Kraljane, komuna e Gjakovës/Đakovica, amvise, tre fëmijë)

Faze Alija me tre djem dhe familjet e tyre jetonin në një shtëpi të përbashkët në Kralan/Kraljane. Forcat serbe e sulmuan fshatin më 2.09.1998, nga drejtimi i fshatit Mrasor. Si pasojë, e tërë familja e Fazes e braktisi shpejt fshatin dhe u strehua në pyllin e quajtur *Lugu i Arave/Dolina njiva [Kralan/Kraljane]*. Në pyll kanë mbetur deri më **17.09.1998**. Atë ditë, nga ora 9:00, forcat serbe filluan të sulmojnë pyllin me predha. Njëra prej tyre ka eksploduar në afërsi të Fazes duke e plagosur atë dhe disa njerëz të tjerë përreth saj. Plagët e Fazes ishin të rënda dhe ajo shpejt u paralizua. Për shkak të granatimeve të pandërprera, familjarët nuk mundnin ta çonin atë në spital dhe ajo ndërroi jetë pas katër ditësh, më 21.09.1998. Të nesërmen, djemtë Elmiu dhe Imeri, me ndihmën e komshinjeve, e kanë varrosur Fazën në varrezat lokale në Kralan/Kraljane.

Burimi: deklarata E.A, FDH-16424.

Adonis (Haxhi) Beci

(15.09.1979, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, tregtar, pjesëtar i UÇK-së)

Xhemajl (Halil) Agushi

(17.10.1981, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Klinës/Klina, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Adonisi u bë anëtar i UÇK-së në qershorin e vitit 1998. Në fillim vepronte pranë shtabit të UÇK-së në fshatin Gllogan/Glo-